

VENDIM
Nr.977, datë 2.7.2008

**PËR RISHPËRNDARJE FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, programi “Forcat e luftimit”, të shtohet fondi 126 500 060 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e pesëqind mijë e gjashtëdhjetë) lekë, për përballimin e shpenzimeve të palës shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian, në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, (operacioni “EUROFOR TCHAD/RCA”), fond, i cili t’i pakësohet programit “Mbështetje e përqendruar”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha